



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 62, dt. 30.03.2016

Në mbështetje të nenit 47 të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 30.03.2016, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratohet projekti për ndërtimin e Linjës 35 kV “Himarë – Dhërmi”, kërkesë e OSHEE.
2. Shtylla nr. 39 e kësaj linje të ketë distancën 150 m nga monumenti “ Kisha Fjetja e Shën Mërise dhe rrënojat e Manastirit të Panaisë”.
3. Gjatë procesit të zbatimit të projektit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikqyren sipas nenit 48 të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI



SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI